

BE-IS SHPK

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE 01.01.2020 – 31.12.2020

Pasqyrat Financiare të vitit 2020 për Subjektin “BE-IS”sh.p.k janë ndërtuar në bazë të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit dhe përkatësisht në mbështetje të plotë të SKK 2.

Kjo shoqëri është regjistruar me objekt aktiviteti në fushën e ndërtimit duke ofruar:

- Ndërtime, konstruksione të ndryshme
- Prodhime, përpunime materiale inerte
- Prodhim, përpunim lëndë drusore
- Import-Eksport, etj

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke ndjekur e zbatuar:

Politikat Kryesore Kontabël:

Politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave e shpenzimeve dhe vlerësimin e tyre.

Parimet Kontabël:

Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, parimi i njësisë ekonomike raportuese, parimi i vijimësisë së veprimtarisë ekonomike si dhe parimi i kompensimit.

Karakteristikat cilësore të informacionit Kontabël:

Karakteristikat kryesore që janë mbajtur parasysh gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2020 janë:

- Kuptueshmëria,
- Rëndësia dhe Materialiteti,
- Besueshmëria,
- Parimi i Paraqitjes me Besnikëri,
- Parimi i Përparësisë së Përmbajtjes Ekonomike mbi Formën Ligjore,
- Paanshmëria,
- Parimi i maturisë,
- Parimi i Plotësisë, Qëndrueshmërisë dhe Krahasueshmërisë.



BILANCI KONTABËL

AKTIVET

Shënimi 1 - Mjete monetare

Nr	Likuiditete	Monedha			Kursi	Ek. Në ALL
		ALL	EUR	USD	29.12.17	
1	Arka	12 441			1	12 441
2	Banka Lekë	98 797 223			1	98 797 223
3	Banka Euro		291 675		124	36 080 198
4	Banka USD			42 293	101	4 264 826
Totali i Zërit Mjete Monetare						139 154 688

Shënimi 2 - Të drejta të arkëtueshme-Nga aktiviteti i shfrytëzimit

Zëri “Nga aktiviteti i shfrytëzimit” në vlerën 1 075 494 438 lekë i referohet vlerës të pa arkëtuar të klientëve (sipas listës bashkëlidhur në pasqyrat financiare) deri në 31 Dhjetor 2020

Shënimi 3.1 – Te tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit(parapagime)

Vlera 2 286 196 lekë nën këtë zë i referohet parapagimeve të bëra nga shoqëria për blerje të lëndëve të para dhe të pambërritura ende.

Shënimi 3.2– Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse

Zëri “Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse” në vlerën 39 101 274 lekë i referohet investimit të bërë nga shoqëria në KALSIS HYDROPOWER, Kukës në të cilin shoqëria BE-IS shpk në masën 99%.

Shënimi 4.1– Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme

Zëri “Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme” në vlerën 5 850 604 lekë i referohet materialeve dhe lëndëve të para të blera nga shoqëria dhe të papërdorura ende në datën 31.12.2020, ato paraqitën me koston e blerjes.

Shënimi 4.2– Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte



Zëri “Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte” në vlerën 43 371 494 lekë i referohet punimeve për vete të kryera dhe të papërfunduara për ndërtimin e një magazine për shoqërinë në Vorë.

Shënimi 5 –Aktive të tjera afatgjata materiale/jo materiale

Zëri “Aktive të tjera afatgjata materiale/jo materiale” në vlerën totale 80 772 526 lekë i referohet aktiveve afatgjata që disponon subjekti të pasqyruara në pasqyrën financiare me vlerën e mbetur pas aplikimit të normave të amortizimit të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. (përjashtim bën “toka” si aktiv afatgjatë jo objekt konsumi)

TOTALI I AKTIVEVE = AKTIVE AFATSHKURTRA + AKTIVE AFATGJATA

= 1 305 258 694 lekë + 80 772 526 lekë = 1 386 031 220 lekë

DETYRIMET DHE KAPITALI

Shënimi 6 –Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Zëri “Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit” në vlerën 725 285 565 lekë nënkupton detyrimin e subjektit ndaj furnitorëve të pa likuiduar deri në 31 dhjetor 2020.

Shënimi 7 –Të pagueshme ndaj punonjësve

Zëri “Të pagueshme ndaj punonjësve” në vlerën 21 582 368 lekë i referohet vlerës së pagave neto të llogaritura të pa paguara ndaj punonjësve.

Shënimi 8 –Detyrime Tatimore

Ky zë në vlerën 14 036 426 lekë analizohet si më poshtë vijon:

- Detyrime ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë në vlerën 1 232 594 lekë për Kontribute Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore muaji Dhjetor 2020.
- Detyrime ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë në vlerën 72 800 lekë për Tatimin mbi të Ardhurat Personale muaji Dhjetor 2020.
- Detyrime ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë në vlerën 2 520 lekë për Tatimin në Burim muaji Dhjetor 2020, që do të paguhet brenda datës 20 Janar 2020.
- Detyrime ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë në vlerën _5 021 768 lekë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar muaji Dhjetor 2017.



- Detyrim për tatim fitimin në shumën 8 939 339 lekë.

Shënimi 9 Te tjera te pagueshme(Parapagime)

Ne kete ze ne shumen 2 289 830 lek perfshihen parapagime te marra nga klientet per punime te cilat nuk jane perfundura brenda vitit ushtrimor 2020.

Shënimi 10 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë

Detyrime ndaj institucioneve të kredisë në shumën 6 326 324 lekë përfaqëson linjën e kredisë me bankën BKT.

Shënimi 11 Të tjera të pagueshme

Të tjera të pagueshme në shumën 1 740 000 lekë përfaqëson detyromin që ka shoqëria ndaj një personi.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas Parimit të Kontabilitetit të të Drejtave të Konstatuara. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogariten me besueshmëri. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin periudhë kontabël me të ardhurat e lidhura.

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve është ndërtuar sipas Natyrës.

Shënimi - Të Ardhurat

Në zërin e “Të ardhura të tjera” 1 045 039 përfshihen të ardhurat nga shitja e kuotave të shoqërisë që ka pasur në Hecin Kalivaç Pukë.

Hartoi

Kristofor Ngjela



Administrator

Kastriot Ibrahimaj